



## **MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT**

### **NDËRMJET**

**UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE-** të cilën e përfaqëson, **z.**  
**Valon Murati, Zv. President për Marrëdhënie me Jashtë i UNI-të**

### **DHE**

**AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI-** të cilën e përfaqëson **znj.**  
**Krenare Sogojeva – Dermaku, Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi**

Prishtinë, 15 gusht 2024

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është realizimi i aktiviteteve të përbashkëta në mes të UNI – Universum International College dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi (në tekstin në vijim: Palët), me theks të veçantë në zhvillimin e njohurive profesionale dhe akademike për studentët të cilët vijojnë studimet në UNI.

## **Neni 2 Fusha e bashkëpunimit**

1. Palët pajtohen që studentët e UNI – Universum International College të angazhohen në punë praktike pa pagesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, nga programet si në vijim:

- Juridik;
- Shkenca Politike;
- Shkenca Kompjuterike;
- Siguri Kibernetike;
- Gazetari Digjitale; dhe
- Fusha të tjera sipas nevojës.

2. Përmes këtij Memorandumi, Agjencia për Informim dhe Privatësi zotohet që sipas mundësive t'u përgjigjet ftesave të UNI-të për organizimin dhe mbajtjen e ligjëratave, seminareve dhe konferencave me qëllim të promovimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për qasje në dokumente publike.

3. Sipas këtij Memorandumi, studentëve të UNI-të u mundësohet që në kuadër të vizitave studimore (*nga programet e ndryshme*) të vizitojnë Agjencinë dhe të njihen me punën e saj, përmes ligjëratave lidhur me të drejtën e privatësisë dhe qasjes në dokumente publike.

## **Neni 3 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe plotësim ndryshimi i Memorandumit**

1. Palët nënshkruese pajtohen që me mirëkuptim dhe konsultim paraprak, të zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit.

2. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshohet, plotësohet dhe ndërpritet sipas pajtimit paraprak në mes të palëve nënshkruese.

## **Neni 4 Kopjet dhe gjuhët e memorandumit të bashkëpunimit**


Ky Memorandum i Bashkëpunimit përgatitet në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**


Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit

**Valon Murati**



Zv. President për Marrëdhënie me Jashtë  
UNI Universum International College

**Krenare Sogjeva - Dërmaku**



Komisionere e Agjencisë  
për Informim dhe Privatësi